

GJYKATA E QARKUT E GJILANIT

Përmes trupit gjykues të përbërë nga Gjyqtarja Civile e EULEX-it ROSITZA BUZOVA si kryetare e trupit gjykues, Gjyqtar vendor MUHAMET REXHA dhe Gjyqtar vendor ABDULLAH AHMETI, si anëtar të trupit gjykues.

Ne lëndën civile të paditësit ISA SALIHU nga fshati LIVOC I POSHTEM, Komuna e GJILANIT, përfaqësuar nga SHEMSEDIN PIRAJ, Avokat nga GJILANI, kundër paditësve JOVAN FILIPOVIC nga fshati LIVOC I POSHTEM, aktualisht me adresë të panjohur, me përfaqësues të përkohshëm TOMISLAV JOVANOVIC, Avokat nga GJILANI, SMIJKA SAVIC nga fshati BUDRIGE e ULET, Komuna GJILANIT, DIVNA STAMENKOVIC nga SMEDEREVA, Serbi, përfaqësuar nga EKREM PIRA, Avokat nga VITIA, SHABAN, VEHBI, FIDAN, FATON, RUHAN dhe SEBAHATE SALIHU, të gjithë nga fshati LIVOC I POSHTEM, Komuna e GJILANIT, aktualisht të gjithë me adresë të panjohur jashtë vendit, përfaqësuar nga ABDYLAZIS SADIKU, Avokat nga GJILANI,

Pas padisë së parashtruar për vërtetimin e drejtës së pronësisë duke u mbështetur në Nenin 254, paragrafi 1 lidhur me Nenin 532, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-006 mbi Procedurë Kontesimore (Publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.38/2008) (Më tej "LPK") me vlerë të kontestit prej 20 000 Euro,

Pas që është vendosur sipas ankesave të ISA SALIHU dhe DIVNA STAMENKOVIC të ushtruara kundër Aktvendimit C.nr.705/2004 të Gjykatës Komunale (GjK) të GJILANIT, të datës 23 korrik 2010 në procedurë të shkallës së dytë sipas Neneve 206 – 211 LPK,

Pas këshillimit dhe votimit lidhur me këto ankesa në seancën e trupit gjykues, sipas Nnenit 190, paragrafi 1, fjalia e parë lidhur me Nenin 208 LPK, të mbajtur me 20 prill 2011,

Përmes kësaj e sipas Nenit 209, pika b) të LPK merr këtë:

A K T V E N D I M

Ankesa e ISA SALIHU nga fshati LIVOC I POSHTEM, Komuna e GJILANIT, oprfaqëuar nga Avokati SHEMSEDIN PIRAJ nga GJILANI dhe ankesa e DIVNA STAMENKOVIC nga SMEDEREVA, Serbi, përfaqësuar nga Avokati EKREM PIRA nga VITIA, **REFUZOHEN** si të pabazuara dhe **VËRTETOHET** Aktvendimi C.nr.705/2004 i Gjykatës Komunale të GJILANIT, ti datës 23 korrik 2010.

A R S Y E T I M

I. Historiati procedural në procedurë të shkallës së dytë

1. Me 23 korrik 2010 GjK e GJILANIT morri Aktvendimin C.nr.705/04 me të cilën padia e ISA SALIHU kundër JOVAN FILIPOVIC, SMIJKA SAVIC, DIVNA STAMENKOVIC, SHABAN, VEHBI, FIDAN, FATON, RUHAN dhe SEBAHATE



SALIHU për vërtetimin e pronësisë konsiderohet e tërhequr, bazuar në Nenin 423, paragrafi 3 LPK. Pagesa për përfaqësuesin e përkohshëm Avokatin TOMISLAV JOVANOVIC për pjesëmarrje në dy seanca në shumë prej 202 Euro dhe për përfaqësuesin e përkohshëm Avokatin ABDYLAZIS SADIKU për paraqitjen e përgjigjes në padi në shumë prej 280 Euro ishin urdhëruar për pagesë nga mjetet e depozituara nga ana e paditësit me kthim të pjesës së papërdorur prej 78 Euro.

2. Me 4 gusht 2010 paditësi ISA SALIHU përmes përfaqësuesit të tij SHEMSEDIN PIRAJ, Avokat nga GJILANI, parashtroj ankesë kundër Aktvendimit C.nr.705/2004 të GjK të GJILANIT, të datës 23 korrik 2010 për shkak të *shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore* sipas Nenit 181, paragrafi 1, pika a) lidhur me Nenin 208 LPK, dhe për shkak të *vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike* sipas Nenit 181, paragrafi 1, pika b) lidhur me Nenin 208 LPK. Kërkesa parashtruar Gjykatës së shkallës së dytë ishte që të aprovohet ankesa, të anulohet Aktvendimi dhe lënda të kthehet në Gjykatën e shkallës së parë në rivendosje.

3. Me 10 gusht 2010 e paditura DIVNA STAMENKOVIC duke vepruar përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar EKREM PIRA, Avokat nga VITIA, gjithashtu parashtroj ankesë kundër Aktvendimit C.nr.705/2004 të GjK të GJILANIT, të datës 23 korrik 2010 për shkak të *shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore* sipas Nenit 181, paragrafi 1, pika a) lidhur me Nenin 208 LPK. Kërkesa e ankueses parashtruar Gjykatës së shkallës së dytë ishte që të aprovohet ankesa e saj duke e ndryshuar Aktvendimin me marrjen e një vendimi meritator ose me anulimin e tij ta kthejë lëndën në gjykatë të shkallës së parë në rivendosje.

4. Kopjet e ankesës së ISA SALIHU janë dërguar me rregull palëve të ankuara nga ana e GjK të GJILANIT për përgjigje, sipa Nenit 187, paragrafi 2 lidhur me Nenin 208 LPK.

5. Me 1 shtator 2010 është parashtruar një përgjigje me shkrim në ankesë të ISA SALIHU e nënshkruar nga i padituri JOVAN FILIPOVIC nga SMEDEREVA, Serbi, me datë të 30 shtator 2010. Kjo e fundit është e papranueshme. *Së pari*, bazuar në Nenin 187, paragrafi 3 lidhur me Nenin 208 LPK ky dokument nuk duhet të shqyrtohet me që nuk është parashtruar sipas rregullit – megjithëse vendbanimi i JOVAN FILIPOVIC është evidentuar në shkresat e lëndës se është në SMEDEREVE, Serbi, nënshkrimi i tij në përgjigje nuk është i vërtetuar zyrtarisht për sa i përket autenticitetit të tij. Prandaj, nuk ka garanci procedurale se ky dokument është i krijuar nga kjo palë në procedurë i cili për 6 vjet të kohëzgjatjes së kësaj lënde kurrë nuk ka marrë pjesë në seancat e saj dhe kurrë nuk ka paraqitur ndonjë parashtrësë. *Së dyti*, kopja e ankesës së ISA SALIHU është pranuar nga ana e përfaqësuesit të përkohshëm të JOVAN FILIPOVIC – Avokati TOMISLAV JOVANOVIC me 18 gusht 2010, i cili që nga ajo datë, bazuar në Nenin 82, paragrafi 2 LPK, ka pas të gjitha të drejta dhe obligime të një përfaqësuesi të të paditurit, duke përfshirë edhe atë të drejtë nga Neni 77, paragrafi 1 dhe Neni 107, paragrafi 1 LPK për të pranuar në emrin e tij dokumentet e dërguara nga Gjykata. Duke llogaritur nga data 18 gusht 2010, periudha e 7 ditëve, sipas Nenit 187, paragrafi 1 lidhur me Nenin 208 LPK për ta parashtruar përgjigjen nga i padituri ka kaluar me 25 gusht 2010. Dokumenti në fjalë është

regjistruar në Gjykatë me 1 shtator 2010 pas skadimit të afatit dhe nuk duhet të merret në shqyrtim nga ana e Gjykatës së shkallës së dytë me që është e vonuar sipas ndalesës urgjente të bazuar në Nenin 187, paragrafi 4 lidhur me nenin 208 LPK.

6. Me që procedura sipas Nenit 187, paragrafi 2 lidhur me Nenin 208 LPK nuk është përmbushur nga ana e Gjykatës së shkallës së parë për sa i përket ankesës së DIVNA STAMENKOVIC, kopjet e saj dhe/ose përkthimet e saj i janë dorëzuar palëve ankuese nga ana e Gjykatës së shkallës së dytë me 12 prill 2011 për tu përgjigjur brenda 7 ditëve nga dita e pranimit. Deri me 19 prill 2011, kur edhe ka kaluar ky afat, përgjigjet nuk janë parashtruar.

II. Kompetencat e trupit gjykues tre-anëtarësh të GjQ të GJILANIT

7. Lënda AC.nr.327/2010 e GjQ të GJILANIT ishte zgjedhur sipas Nenit 5, paragrafi 1, pika c) të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë ("Ligji Nr. 03/L-053") me një Aktvendim të Gjyqtarit të EULEX-it, i datës 16 dhjetor 2010. Seanca dëgjimore, sipas Nenit 5, paragrafi 7, fjalia e parë e Ligjit Nr. 03/L-053, është mbajtur me 22 shkurt 2011 nga Gjyqtari i EULEX-it – I deleguari i Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it sipas Vendimit ref.nr.JC/EJU/OPEJ/2230/mgc/11, të datës 28 janar 2011. Me Aktvendimin e kësaj të fundit, me 24 shkurt 2011 lënda i është caktuar trupit gjykues tre-anëtarësh të GjQ të GJILANIT sipas Nenit 5, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-053, me një Gjyqtar të EULEX-it, si Kryetar të trupit gjykues dhe dy Gjyqtar vendor- si anëtarë, të emëruar pas Vendimit mbi përjashtim ref.nr.JC/EJU/OPEJ/2298/mgc/11 të Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, të datës 3 mars 2011 sipas Nenit 5, paragrafi 5 të Ligjit Nr. 03/L-053 me Vendimin Agj.nr.39/2011 të Kryetarit të GjQ të GJILANIT, të datës 9 mars 2011.

8. Duke qenë i përbërë sipas ligjit dhe në pajtim me kriteret specifike të Nenit 5, paragrafët 1, 2, 4, 5 dhe 7 të Ligjit Nr. 03/L-053, ky trup gjykues tre-anëtarësh i GjQ të GJILANIT është i autorizuar të gjykoj lëndën AC.nr.327/2010 bazuar në kompetencat e përgjithshme vepruese të Gjykatës së shkallës së dytë sipas Nenit 15, paragrafi 2 dhe Nenit 176, paragrafi 3 lidhur me Nenin 208 LPK.

III. Lejueshmëria e ankesave

9. Nuk ekzistojnë pengesa procedurale për të vendosur lidhur me ankesat kundër Aktvendimit C.nr.705/04 të GjK të GJILANIT, të datës 23 korrik 2010. *Së pari*, paraqitja e tyre nuk është shprehimisht e ndaluar me LPK siç kërkohet sipas Nenit 206, paragrafi 1. Aktvendimi është për ndërprerjen e procedurës me tërheqje të padisë pas seancës përgatitore- Article 390, paragrafi 1, pika e) LPK, sikurse edhe për shpenzimet procedurale për përfaqësuesit e përkohshëm- Neni 466, paragrafi 2 LPK. Me këtë përmbajtje, ai është tërësisht i ankueshëm. *Së dyti*, ankesat nuk janë të pa afatshme sipas Nenit 186, paragrafi 2 lidhur me Nenin 208 LPK. Aktvendimi C.nr.705/2004 i GjK të GJILANIT, i datës 23 korrik 2010 i është dorëzuar përfaqësuesit të ISA SALIHU – Avokatit SHEMSEDIN PIRAJ me 29 korrik 2010, dhe përfaqësuesit të DIVNA STAMENKOVIC- Avokatit EKREM PIRA me 31 korrik 2010. Ankesat e tyre janë parashtruar me 4 dhe 6 gusht 2010, përkatësisht brenda afatit 15 ditor siç është paraparë sipas Nenit 176, paragrafi 1, fjalia e parë,

lidhur me Nenin 208 LPK. *Së treti*, asnjëra nga këto dy ankesa nuk janë të palejueshme sipas Nenit 186, paragrafi 3 lidhur me Nenin 208 LPK. Ato ishin parashtruar në emër të palëve në procedurë me të drejtë dhe me interes ligjor për t'i paraqitur ato- Neni 176, paragrafi 1 lidhur me Nenin 208 LPK, jo për të hequr dorë nga drejta e ankimit apo për t'i tërhequr të njëjtat. E para është nënshkruar për ISA SALIHU nga ana e Avokatit SHEMSEDIN PIRAJ me autorizim, të datës 4 gusht 2004 për ta përfaqësuar atë në procedurë gjyqësore gjatë të gjitha fazave të procedurës. E dyta është nënshkruar për DIVNA STAMENKOVIC nga ana e Avokatit EKREM PIRA me autorizim të dorëzuar në shkresat e lëndës me 3 qershor 2010 e cila është e përgjithshme dhe brenda veprimeve të autorizuarra përshinë edhe të drejtën për t'i përdorur të gjitha mjetet juridike- Neni 90, paragrafi 2 LPK. *Së katërti*, nuk ekzistojnë elementet e paplotësuarra sipas Nenit 179, paragrafi 1 lidhur me Nenin 208 LPK – çdo ankesë ka formën dhe përmbajtjen e detyrueshme të paraparë me Nenin 178, pikat a) – d) lidhur me Nenin 208 LPK. Shkurtë, nuk ka baza ligjore që e përjashtojnë lejueshmërinë e ankesave dhe të kësaj procedure të shkallës së dytë sipas Neneve 206 – 211 LPK.

IV. Konstatimet për procedurat e shkallës së parë lidhur me ekzaminimin ankimor

10. Padia C.nr.705/2004 e GjK të GJILANIT është parashtruar me 3 gusht 2004 nga ana e ISA SALIHU nga fshati LIVOC I POSHTEM, Komuna e GJILANIT përmes përfaqësuesit të tij Avokatit SHEMSEDIN PIRAJ kundër VACKO FILIPOVIC, i cili aktualisht jeton në SMEDEREVO, Serbi, në një adresë të panjohur.

11. Sipas pretendimeve në pjesën provuese të padisë ISA SALIHU ka blerë, në mes të vitit 1979 përmes një kontrate gojore me VACKO FILIPOVIC, ngastrën kadastrale nr.993 në vendin e quajtur "RID", me kulturë – arë e klasit të parë, në sipërfaqe prej 0.37.98 ha, të evidentuar në Listën Poseduese nr.258, Zona Kadastrale nr.70403020- LIVOC I POSHTEMn në meër tani të ndjerit DUSAN (VLADIMIR) FILIPOVIC për çmimin prej 40 000 DEM. Siç kanë ra dakord, kjo shumë është paguar në dy këste – i pari në shumë prej 20 000 DEM në momentin kur është lidhur kontrata dhe i dyti në shumë prej 20 000 DEM - 6 muaj më vonë. Pas pagesës së çmimit të plotë, palët shkuan në vend, e identifikuan paluajtshmërinë e blerë dhe e njëjta është dorëzuar nga shitësi te blerësi. Me që të dytë i kishin përmbushur obligimet e veta sipas kontratës së tyre gojore, ajo duhet të konsiderohet si e vlefshme sipas Nenit 73 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore (Publikuar në Gazetën Zyrtare të RSFJ Nr. 29/1978, me ndryshime në Nr. 39/1985, 45/1989, 57/1989, ndryshimet përfundimtare në Gazetën Zyrtare të RFJ Nr.31/1993). ISA SALIHU e ka fituar pronësinë gjithashtu në bazë të parashkrimit fitues - Neni 28, paragrafi 4 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronëso-ro-Juridike (Publikuar në Gazetën Zyrtare të RSFJ Nr. 6/1980) me që ai e ka shfrytëzuar ngastrën kontestuese pandërprerë si mbajtës me mirëbesim që nga viti 1979 pa u penguar nga i padituri e as nga ana e dikujt tjetër.

12. Arsyetimet janë se Gjykata do të vërtetoj pronësinë e paditësit mbi ngastrën kadastrale të sipërpërmendur, bazuar në shitblerjen e vitit 1979 dhe parashkrimit fitues, i padituri do të obligohet të ia njoh këtë të drejtë dhe të duroj kështu që të kryhet regjistrimi i paluajtshmërisë në emër të paditësit nga ana e Drejtoratit për

Gjeodezi, Cadastër dhe Pronë – GJILAN brenda 15-ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të Aktgjykimit.

13. Kualifikimi ligjor i padisë është për konfirmimin e të drejtës së pronësisë me Aktgjykim sipas Nenit 187, paragrafi 1 të Ligjit mbi Procedurë Kontestimore (Publikuar në Gazetën Zyrtare të RSFJ NR.4/76 me ndryshime në Nr.36/1977, 36/1980, 69/1982, 54/1984, dhe 74/1987) (pas 6 tetorit 2008 korrespondon me Nenin 254, paragrafi 1 LPK). Vlera e tij fillimisht është përcaktuar nga ana e paditësit në vlerë prej 1 050 Euro.

14. me 22 nëntor 2004 është paraqitur një parashtrësë nga ana e Avokatit SHEMSEDIN PIRAJ për përmirësimin e padisë për sa i përket emrit personal të të paditurit, nga "VACKO" në "JOVAN", ndërsa mbiemri i tij "FILIPOVIC" mbeti i pandryshuar. Kështu, padia duhet të konsiderohet e përmirësuar në mënyrë retroaktive nga regjistrimi i saj i parë në Gjykatë (Neni 109, paragrafi 2 të Ligjit mbi Procedurë Kontestimore).

15. Me që adresa e të paditurit JOVAN FILIPOVIC ishte e panjohur për paditësin dhe nuk ishte shënuar në padi, Gjykata, sipas *detyrës zyrtare*, ka ndërmarrë masa për identifikimin e saj duke i dërguar me 29 mars 2007, me 7 shkurt 2008 një kërkesë për informacion Shërbimit Policor të Kosovës, Qendrës për Punë Sociale dhe Zyrës për Regjistrim Civil. Bazuar në përgjigjet e pranura nga ana e Qendrës për Punë Sociale me 4 qershor 2007 dhe nga Shërbimit Policor të Kosovës me 8 prill 2008, vendbanimi dhe adresa e JOVAN FILIPOVIC nuk ka mund të verifikohet përveç se ai jeton në Serbi.

16. Duke marrë parasysh këto konstatime zyrtare dhe mungesën e përfaqësuesve të autorizuar të të paditurit në këtë lëndë, me Aktvendimin C. nr.705/04 të GjK të GJILANIT, të datës 16 korrik 2008 sipas Nenit 84, paragrafi 2, pika 5 lidhur me Nenin 278 të Ligjit mbi Procedurë Kontestimore, Avokati TOMISLAV JOVANOVIC është emëruar për përfaqësues të përkohshëm me të gjitha të drejta dhe obligime të përfaqësuesit ligjor deri në paraqitjen e këtij ndërgjyqësit para Gjykatës ose caktimin e kujdestarit për te nga ana e autoritetit kompetent të kujdestarisë.

17. Në ndërkohë, me Aktgjykimin C.nr.166/2007 të GjK të GJILANIT, të datës 5 nëntor 2007, padia e NAZIM SALIHU (vëllai i ISA SALIHU) e ushtruar kundër DUSAN FILIPOVIC (baba i JOVAN FILIPOVIC) ishte aprovuar me konfirmimin e pronësisë së këtij paditësi mbi ngastrën kadastrale nr.P-704030320-00993-0 në vendin e quajtur "RID", në sipërfaqe prej 3 798 m², të regjistruar në Certifikatën nr.258, Zona Kadastrale LIVOC I POSHTEM. Në këtë Aktgjykim nuk është paraqitur ankesa dhe bazuar në vulën e plotfuqishmërisë së Gjykatës vendosur mbi të i njëjti hyri në fuqi me 30 nëntor 2007.

18. Me Aktvendimin C.nr.705/2004 të GjK të GJILANIT, të datës 7 gusht 2008 kjo procedurë kontestimore është pezulluar deri në sjellje të vendimit të plotfuqishëm të lëndës në zhvillim e sipër për anulimin e Aktgjykimit C.nr.166/2007 të GjK të GJILANIT, të datës 5 nëntor 2007. Në arsyetim përfundimi i lëndës tjetër është konstatuar të jetë i paragjykuar me që është vendosur me Aktgjykim të plotfuqishëm për aprovimin e padisë për vërtetimin e pronësisë ndërmjet palëve të ndryshme për ngastrën e njëjtë kadastrale nr.993. Prandaj, mbi pezullimin i lëndës C.nr.705/04 të

GjK të GJILANIT është vendosur në bazë të Nenit 12 lidhur me Nenin 278 dhe Nenin 213, paragrafi 1, pika 1 të Ligjit mbi Procedurë Kontestimore.

19. Propozimi i ISA SALIHU për përsëritjen e procedurës i përfunduar me Aktgjykim të plotfuqishëm C.nr.166/2007 të GjK të GJILANIT, të datës 5 nëntor 2007, ishte hedh poshtë me Aktvendimin C.nr.166/2007 të GjK të GJILANIT, të datës 25 maj 2009, mandej i ankimuar nga ai dhe i konfirmuar me Aktvendimin AC.nr.205/2009 të GjQ të GJILANIT, të datës 13 tetor 2009. të dyja shkallët pranuan që si *person i tretë* në procedurë në lëndën C.nr.166/2007, ISA SALIHU nuk kishte të drejtë të inicioj procedurë për masë ligjore të jashtëzakonshme.

20. Si pasojë, me Aktvendimin C.nr.705/2004 të GjK të GJILANIT, të datës 19 nëntor 2009 ishte aprovuar propozimi i përfaqësuesit të paditësit- Avokatit SHEMSEDIN PIRAJ për vazhdimin e kësaj lënde të suspenduar bazuar në Nenin 280, paragrafi 3 lidhur me Nenin 532, paragrafi 1 LPK.

21. Me 30 nëntor 2009 i njëjti përfaqësues paraqiti parashtresë për precizimin e padisë për sa i përket fushëveprimit objektiv dhe subjektiv të saj. *Së pari*, me caktimin e të paditurëve- JOVAN FILIPOVIC, SMILJKA SAVIC, DIVNA STAMENKOVIC – si trashëgimtarë të të ndjerit DUSAN FILIPOVIC, sikurse edhe të SHABAN SALIHU, VEHI SALIHU, FATON SALIHU, FIDAN SALIHU, RUHAN SALIHU dhe SEBAHATE SALIHU – si trashëgimtarë të të ndjerit NAZIM SALIHU. Adresat e disa nga të të paditurve ishin të shënuar në parashtresë, ndërsa për të tjerët ishin të përmendur vetëm shtetet e vendqëndrimeve të tyre aktuale. *Së dyti*, vlera fillestare e kontestit ishte ngritur deri në 20 000 Euros. *Së treti*, kërkesëpapia ishte zgjeruar me kërkesë të re për hedhjen poshtë të Aktgjykimit të plotfuqishëm C.nr.166/07 të GjK të GJILANIT, të datës 5 nëntor 2007.

22. Me Aktvendimin C.nr.705/04 të GjK të GJILANIT, të datës 24 shkurt 2010 në pajtim me Nenin 102, paragrafi 1 LPK paditësi është obliguar që në afat prej 15 ditëve nga marrja e tij të përmirësoj padinë duke i shënuar adresat e sakta të paditurve SHABAN, VEHI, FATON SALIHU me qëndrim në Britani të Madhe dhe të FIDAN, RUHAN dhe SEBAHATE SALIHUT – në Zvicër. Më tej, paditësit i është tërheq vërejtja që në rast të mosrespektimit padia do të hudhet poshtë sipas Nenit 102, paragrafi 3 LPK.

23. Me parashtresën e 5 marsit 2010, përfaqësuesi i paditësit- Avokati SHEMSEDIN PIRAJ e informoi Gjykatën se adresat e kërkuara të SHABAN, VEHI, FATON, FIDAN, RUHAN dhe SEBAHATE SALIHUT ishin të panjohura për klientin e tij dhe përkundër përpjekjeve të bëra ai nuk arriti t'i siguroj ato, dhe për këtë shkak ai propozoi caktimin e përfaqësuesit të tyre të përkohshëm.

24. Me Aktvendimin C.nr.705/04 të GjK të GJILANIT, të datës 2 prill 2010 Avokati ABDYLAZIS SADIKU nga GJILANI është caktuar si përfaqësues i përkohshëm i SHABAN, VEHI, FATON, FIDAN, RUHAN dhe SEBAHATE SALIHUT sipas Nenit 79, paragrafi 3 dhe Nenit 81, paragrafi 1 LPK, me të drejtat dhe obligimet e një përfaqësuesi derisa këta të paditur paraqiten para Gjykatës ose të caktohet një kujdestar për ata nga autoriteti kompetent i kujdestarisë. Paditësi ishte obliguar që brenda 15 ditëve të depozitoj shumën prej 280 Euro për harxhimet e përfaqësuesit të përkohshëm, siç është paraparë me Nenin 81, paragrafi 2 LPK.

25. Seanca përgatitore e lëndës C.nr.705/2004 të GjK të GJILANIT, ishte caktuar për 14 korrik 2010. Të gjitha palëve iu janë dërguar thirrjet për seancë më shumë se 7 ditë para datës së seancës (Neni 402, paragrafi 2 LKP) – paditësit ISA SALIHU përmes Avokatit SHEMSEDIN PIRAJ me 8 qershor 2010 (Neni 107, paragrafi 1 LKP), të padituri JOVAN FILIPOVIC përmes Avokatit të tij TOMISLAV JOVANOVIC me 7 qershor 2010 (Neni 107, paragrafi 1 dhe Neni 82, paragrafi 1 LKP), të paditurës SMILJKA SAVIC personalisht me 12 qershor 2010 (Neni 110, paragrafi 1, fjalia e parë LKP), të paditurës DIVNA STAMENKOVIC përmes Avokatit të saj EKREM PIRA me 8 qershor 2010 (Neni 107, paragrafi 1 LKP) dhe të paditurve SHABAN, VEHBI, FATON, FIDAN, RUHAN dhe SEBAHATE SALIHU përmes Avokatit të tyre ABDYLAZIS SADIKU me 8 qershor 2010 (Neni 107, paragrafi 1 dhe Neni 82, paragrafi 1 LKP).

26. Në seancën përgatitore me 14 korrik 2010 paditësi ISA SALIHU ishte i pranishëm me Avokatin e tij SHEMSEDIN PIRAJ, për të paditurit JOVAN FILIPOVIC i pranishëm ishte Avokati TOMISLAV JOVANOVIC, SMILJKA SAVIC u paraqit personalisht, DIVNA STAMENKOVIC ishte përfaqësuar nga Avokati EKREM PIRA, dhe SHABAN, VEHBI, FATON, FIDAN, RUHAN dhe SEBAHATE SALIHU të gjithë ishin të përfaqësuar nga Avokati ABDYLAZIS SADIKU. Nuk ka pas vërejtje nga ndonjë pjesëmarrës në seancën përgatitore lidhur me rregullsinë apo udhëheqjen e saj. Gjatë seancës Avokati SHEMSEDIN PIRAJ paraqiti padinë në emër të paditësit; pas kësaj të paditurit personalisht ose përmes përfaqësuesve të tyre u përgjigjen lidhur me këtë– Neni 403, paragrafi 1 LKP. Nuk ka pas pengesa procedurale të identifikuara sipas *detyrës zyrtare* ose përmes vërejtjeve apo kundërshtimeve të palëve për të vendosur në seancën përgatitore- Neni 404, paragrafët 1 dhe 2 LKP. Propozimet e palëve për faktet që duhet të vërtetohen dhe provat që duhet të mblidhen janë diskutuar në këtë gjykim - Neni 405 LKP.

27. Në fund të seancës përgatitore GjK e GJILANIT morri Aktvendim sipas Nenit 420, paragrafi 1, pikat a)–d) LKP për caktimin e seancës kryesore për 23 korrik 2010 në ora 10.00, për caktimin e çështjeve që duhet të shqyrtohen me provat që duhet të mblidhen gjatë procedurës sikurse edhe për të identifikuar personat të cilëve duhet t’ju dërgohen ftesat për gjyq. Gjykata urdhëroj dërgimin e thirrjeve për SHABAN, VEHBI, FATON, FIDAN, RUHAN dhe SEBAHATE SALIHU bazuar në informacionet e Avokatit ABDYLAZIS SADIKU se ata mund të vijnë për pushime verore në fshatin LIVOC I POSHTEM, ata mund të dëgjohen sipas Nenit 373 LKP. Për sa i përket përfaqësuesit të autorizuar të paditësit Acokatit SHEMSEDIN PIRAJ, përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit JOVAN FILIPOVIC- Avokati TOMISLAV JOVANOVIC, e paditura SMILJKA SAVIC personalisht, përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës DIVNA STAMENKOVIC – Avokati EKREM PIRA dhe përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurve tjerë- Avokati ABDYLAZIS SADIKU, me që ishin prezent në seancë përgatitore të gjithë u informuan për seancën kryesore dhe për atë Gjykata urdhëroj të mos dërgohet atyre thirrjet për seancë sipas Nenit 421, paragrafi 1 LKP.

28. Seanca kryesore në lëndën C.nr.705/2004 të GjK të GJILANIT është mbajtur në datën e caktuar me Aktvendim sipas Nenit 420, paragrafi 1, pika a) LKP – me 23 korrik 2010. Seanca filloj në ora 10:25, me vonesë të parëndësishme pas kohës së caktuar për në ora 10:00. Publiku, sipas Nenit 444, paragrafi 1 LKP nuk është

përfunduar për asnjërën palë në gjykim e as për të tjerë që nuk janë palë në procedurë. Gjyqtari i lëndës e shpalli seancën e hapur dhe objektin e shqyrtimit – Neni 423, paragrafi 1 LPK. Pastaj, ai verifikoi prezencën e palëve - Neni 423, paragrafi 2 LPK dhe përfundoi se paditësi ISA SALIHU dhe përfaqësuesi i tij Avokati SHEMSEDIN PIRAJ mungonin pa ndonjë arsye të justifikueshme. Për të paditurit JOVAN FILIPOVIC Avokati i tij TOMISLAV JOVANOVIC ishte prezent, për SAVIC SMILKA dhe DIVNA STAMENKOVIC nuk ishte askush, SHABAN, VEHBİ dhe FIDAN SALIHU ishin aty personalisht, sikurse edhe Avokati ABDYLAZIS SADIKU si përfaqësues i përkohshëm i tyre si dhe i FATON, RUHAN dhe SEBAHATE SALIHU. Asnjëri nga këta pjesëmarrës në seancë kryesore nuk kërkuan vazhdimin e seancës në mungesë të paditësit. Përkundrazi, të gjithë unanimisht deklaruan se ata nuk kanë interes ligjor në gjykimin e mëtejshëm të kësaj lënde dhe i propozuan Gjykatës sipas Nenit 423, paragrafi 3 LPK që të konsideroj padinë si të tërhequr me që paditësi dhe përfaqësuesi i tij Avokati SHEMSEDIN PIRAJ ishin njoftuar rregullisht dhe nuk e arsyetuan mungesën e tyre në seancë kryesore.

29. Me 23 korrik 2010 GjK e GJILANIT morri Aktvendim me të cilin C.nr.705/2004 me të cilën padia e paditësit ISA SALIHU e ushtruar kundër të paditurve JOVAN FILIPOVIC, SMIJKA SAVIC, DIVNA STAMENKOVIC, SHABAN, VEHBİ, FIDAN, FATON, RUHAN dhe SEBAHATE SALIHU mbi konfirmimin e pronësisë, konsiderohet e tërhequr sipas Nenit 423, paragrafi 3 LPK. Në pjesën e dytë të diapozitivit është vendosur për pagesë të përfaqësuesit të përkohshëm Avokatit TOMISLAV JOVANOVIC për pjesëmarrje në dy seanca në shumë prej 202 Euro dhe për pagesë të përfaqësuesit të përkohshëm Avokatit ABDYLAZIS SADIKU për ushtrimin e përgjigjes në shumë prej 280 Euro për tu paguar nga depozita e paditësit, me kthim të pjesës së papërdorur prej 78 Euro.

VI. Ekzaminimi ankimor sipas Nenit 194 lidhur me Nenin 208 LPK

Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore - Neni 182 LPK

30. Arsyeja e parë në ankesat e ISA SALIHU dhe DIVNA STAMENKOVIC bazohet në Nenin 181, paragrafi 1, pika a) lidhur me Nenin 208 LPK për shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore sipas Nenit 182, paragrafi 1 LPK për shkak të aplikimit të gabueshëm të Nenit 423, paragrafi 3 LPK lidhur me marrjen e Aktvendimit C.nr.705/04 të GjK të GJILANIT, të datës 23 korrik 2010.

31. Sipas Nenit 423, paragrafi 3 LPK nëse në seancën për shqyrtim kryesor nuk paraqitet paditësi i cili është thirrur sipas rregullit atëherë do të supozohet se ai apo ajo e ka tërhequr padinë përveç se në rastet kur i padituri kërkon që seanca të mbahet pa prezencën e paditësit. Në rastin e tanishëm të gjitha kushtet sipas kësaj dispozite janë përmbushur.

32. Çdë njëra palë ankuese ka pranuar dhe nuk është kundërshtuar nga asnjëra palë kundërshtare se seanca gjyqësore e 23 korriku 2010 ishte caktuar si *seancë për shqyrtim kryesor* sipas Nenit 12, pika b) LPK në procedurë për lëndën C.nr.705/2004 të GjK të GJILANIT. Ajo i ka këto karakteristika për shkak të rënditjes dhe përmbajtjes së fazave të mëparshme të gjykimit. Kjo do të thotë, me 14 korrik 2010 një seancë përgatitore sipas Nenit 12, pika a) LPK është mbajtur sipas Nenit 401 LPK,

në të cilin përfaqësuesi i paditësit paraqiti kërkesëpadinë, të paditurit e pranishëm ose përfaqësuesit e tyre dhanë përgjigje në atë kërkesëpadi - Neni 403, paragrafi 1 LPK, pastaj propozimet e palëve u diskutuan - Neni 405 LPK për faktet që duhet të vërtetohen dhe provat që duhet të sjellen në shkresat e lëndës, për objektin e *shqyrtimit kryesor* dhe provat për t'i grumbulluar ish-in vendosur nga ana e Gjykatës gjatë procedurës - Neni 406, paragrafi 1 LPK, me një Aktvendim sipas 420, paragrafi 1, pikat a) – d) LPK. Me këtë Aktvendim seanca e 23 korrikut 2010 ishte kualifikuar në mënyrë të qartë nga Gjykata e shkallës së parë si seancë për *shqyrtim kryesor* të çështjes. Pastaj, njoftimi i Gjyqtarit në fillim të seancës me 23 korrik 2010 në pajtim me Nenin 423, paragrafi 1 LPK ishte për hapjen e saj si *seancë kryesore*, dmth. një seancë në të cilën palët duheshin ti prezantojnë faktet për t'i mbështetur propozimet e tyre, për t'i sjell provat, për të dhënë deklarata lidhur me propozimet e palëve kundërshtare - Neni 428 LPK dhe për të shpreh pikëpamjet ligjore lidhur me lëndën e çështjes që është në shqyrtim, duke përfshirë fjalën përfundimtare – Neni 429 LPK. Ose, duke marrë parasysh strukturën e gjykimit të lëndës C.nr.705/2004 të GJK të GJILANIT deri me 23 korrik 2010, seanca gjyqësore në atë datë përmbushi të gjitha kriteret për të qenë *seancë kryesore* në procedurë të shkallës së parë sipas Nenit Article 12, pika b) LPK. Për atë, mosparaqitja e paditësit dhe përfaqësuesit të tij në atë seancë ka pasojë ligjore të parapara me Nenin 423, paragrafi 3 LPK.

33. Seanca për shqyrtim kryesor në fjalë ishte e *caktuar sipas rregullit*. Së pari, ishte thirrur me Aktvendim të shkallës së parë i cili e përcaktoi datën dhe kohën e mbajtjes – Neni 420, paragrafi 1, pika a) LPK, çështjet për t'i vlerësuar dhe për t'i diskutuar gjatë procedurës – Neni 420, paragrafi 1, pika b) LPK, provat për t'i grumbulluar – Neni 420, paragrafi 1, pika e) LPK dhe personat për t'i thirrur në seancë – Neni 420, paragrafi 1, pika d) LPK. Pra, kjo seancë kryesore është thirrur përmes një akti valid gjyqësor me përmbajtje ligjore. Së dyti, periudha 30 ditëshe për mbajtjen e seancës kryesore pas përfundimit të seancës përgatitore, parapara me Nenin 420, paragrafi 2 LPK, është udhëzuese me që Neni 420, paragrafi 3 LPK autorizon Gjykatën për të vendosur se seanca kryesore *mbahet* menjëherë pas seancës përgatitore. Për atë, intervali kohor ndërmjet seancave gjyqësore me 14 dhe 23 korrik 2010 ishte i lejueshëm për shkak se kohëzgjatja e tij kaloj periudhën 8 ditëshe sipas Nenit 367 LPK. Së treti, për sa kohë që palët ishin të pranishëm në seancën përgatitore ose të përfaqësuar në atë seancë, të gjithë ishin të njoftuar për Aktvendimin sipas Nenit 420, paragrafi 1 LPK gjatë kohës kur ai ishte sjellë. Prandaj, pas kësaj nuk është dashur t'i dërgohet thirrja asnjërit nga palët në procedurë sipas Nenit 421, paragrafi 1 LPK. Sipas dispozitës së njëjtë atyre nuk është dashur t'ju dërgohen thirrjet për seancë kryesore meqenëse të gjithë ishin njoftuar për datën dhe kohën e saj të caktuar gjatë seancës përgatitore. Së katërti, në pajtim me Nenin 421, paragrafi 2 LPK Gjykata e shkallës së parë e njoftoi paditësin i cili ishte i pranishëm në seancën përgatitore rreth obligimit të tij që të merr pjesë në seancë kryesore dhe për pasojat procedurale në rast të mosparaqitjes në të. Udhëzime të ngjajshme nuk u nevojiteshin për të paditurit meqenëse mungesa e tyre në seancë kryesore nuk mund të pengoj ligjërisht mbajtjen e saj – Neni 423, paragrafi 4 LPK dhe nuk mundet me pas ndonjë ndikim negativ procedural për ata. Së pesti, megjithëse lënda C.nr.705/04 e GJK të GJILANIT filloj me 3 gusht 2004, para hyrjes në fuqi të LPK me 6 tetor 2008, procedura e kësaj lënde të pakryer në shkallën e parë pas kësaj date duhej të

vazhdohej sipas dispozitave të kështij ligji të ri, duke përfshirë ligjet e aplikueshme për mbajtjen e seancës kryesore, bazuar në parimi e përgjithshëm kalimtar të Nenit 532, paragrafi 1. Me që në rastin konkret, as seanca përgatitore e as ajo për shqyrtim kryesor nuk është mbajtur para 6 tetorit 2008, kur edhe ka hyrë në fuqi ligji i ri për Procedurë Kontestimore, parimet specifike kalimtare të Nenit 532, paragrafët 2 ose 3 LPK nuk ishin të aplikueshme. Shkurtimisht, me kusht që të gjitha kriteret e Ligjit të ri- LPK për caktimin e rregulltë të seancave për shqyrtim kryesor janë përmbushur nga ana e Gjykatës së shkallës së parë, me që mbajtja e saj është juridikisht valide mund të prodhoj të gjitha efekte procedurale të përcaktuara për këtë fazë të gjykimit, duke përfshirë edhe ato sipas Nenit 423, paragrafi 3 LPK për tërheqjen e konsideruar të padisë.

34. Seanca për shqyrtim kryesor ishte caktuar për *23 korrik 2010 në ora 10.00*. Kjo datë dhe kjo kohë janë caktuar me Aktvendim të marrë në seancën përgatitore të mbajtur me 14 korrik 2010 sipas Nenit 420, paragrafi 1, pika a) LPK. Çfarë do propozime të kishte pas nga ana e palëve për sa i përket datës së mundshme për seancë kryesore dhe diskutime lidhur me atë çështje, ato janë proceduralisht relevante dhe *anasjelltas* është proceduralisht relevant vetëm vendimi i plotfuqishëm i Gjykatës për ta mbajtur atë me 23 korrik 2010, në ora 10.00. Kundër kësaj të fundit nuk lejohet ankimi sipas Nenit 387, paragrafi 2 LPK dhe si rjedhim ka prodhuar efekte ligjore menjëherë pas marrjes së tij, duke përfshirë datën dhe kohën e seancës për shqyrtim kryesor. Kjo ka hyrë sipas rregullit në Procesverbal nga seanca përgatitore me 14 korrik 2010, e mbajtur sipas Nenit 134, paragrafi 1 LPK, në formë të shkruar dhe me përmbajtje si të paraparë sipas Nenit 134, paragrafi 3 dhe Nenit 135 LPK. Asgjë nuk është hequr, shtuar apo ndryshuar, asnjë Nen nuk është kaluar dhe teksti është krejtësisht i lexueshëm siç kërkohet me Nenin 136 LPK. Në veçanti, nuk ka përmirësime për sa i përket datës së seancës për shqyrtim kryesor- në paragrafin përkatës, në faqën e dytë, *është shkruar qartë siç e caktuar me 23 korrik 2010*. Në pajtim me Nenin 139, paragrafi 1 LPK Procesverbali është i nënshkruar nga Gjyqtari i emëruar për lëndën C.nr.705/2004 dhe nga procesmbajtësi, sikurse edhe nga të gjitha palët dhe përfaqësuesit e pranishëm me 14 korrik 2010. Nuk ka shënim sipas Nenit 139, paragrafi 4 LPK për mos-nënshkrimin ose refuzimin për ta nënshkruar nga ana e ndonjë pjesëmarrësi në gjykim. ISA SALIHU dhe përfaqësuesi i tij Avokati SHEMSEDIN PIRAJ, sikurse edhe Avokati EKREM PIRA si përfaqësues i DIVNA STAMENKOVIC nënshkruan Procesverbalin e datës 14 korrik 2010 pa ndonjë kundërshtim, sipas Nenit 137, paragrafi 2 LPK, për sa i takon përmbajtjes në përgjithësi dhe/ose datës së seancës për shqyrtim kryesor- 23 korrik 2010. Pra, ndryshime, korrigjime ose shtesa lidhur me atë nuk janë shënuar në tekst- Neni 137, paragrafi 3 LPK. Me që çdonjëri nga ankuesit e lexoi Procesverbalin nga seanca përgatitore e datës 14 korrik 2010 pas përfundimit të saj dhe e nënshkroi pa ndonjë kundërshtim sipas Nenit 137, paragrafi 2 LCP, ata e humbën të drejtën për ta përdorur mjetin e *veçantë* juridik kundër parregullsive në tekstin e shënuar dhe nuk mund të parashtronjë atë përmes mjeteve tjera të *përgjithshme* juridike, duke përfshirë ankesat sipas Nenit 206 LPK. Kështu, të gjitha argumentet e ankuesëve për shënimin e gabueshëm të datës së seancës për shqyrtim kryesor në Procesverbalin nga seanca përgatitore pasi që është thirrur pas afatit të paraparë me Nenin 137, paragrafi 2 LPK janë të pa afatshme. Ato janë gjithashtu të palejueshme me që mund të aprovohen apo

jo nga Gjykata e shkallës së parë sipas Nenit 137, paragrafi 2 LPK, dhe *anasjelltas* nuk mund t'i nënshtrohen shqyrtimit ankimor për aprovim nga ana e Gjykatës së shkallës së dytë në procedurë sipas Nenit 208 – 211 LPK.

35. Me që Procesverbali nga seanca përgatitore e datës 14 korrik 2010 është përpiluar në formë të duhur nga ana e GjK të GJILANIT si një autoritet publik me kompetencat e veta, ky Procesverbal paraqet *dokument zyrtar* i cili sipas Nenit 329, paragrafi 1 LPK *dëshmon vërtetësinë e asaj çka është thënë ose vërtetuar këtu*. Për sa i përket këtij *efekti detyrues të provave*, kjo Gjykatë e shkallës së dytë pranon se përmbajtja e seancës përgatitore *verbalisht* të mbajtur me 14 korrik 2010 siç është paraparë sipas Nenit 427 lidhur me Nenin 410 LPK *i përgjigjet* atij të *shkruar* në Procesverbal. Për atë, të gjitha veprimet procedurale të ndërmarra në seancën e 14 korrikut 2010 duhet të konsiderohen *saktësisht* si të përfshira në Procesverbal sipas Nenit 135, paragrafi 2 LPK. Kjo vlenë edhe për Aktvendimin e Gjykatës të marrë në seancën përgatitore, sipas Nenit 420, paragrafi 1 LPK – bazuar në efektin detyrues të provave të Procesverbalit sipas Nenit 329, paragrafi 1 LPK duhet të konsiderohet se *data e shprehur verbalisht nga ana e Gjyqtarit të emëruar në këtë lëndë C.nr.705/04 kur është thirrur seanca përputhet me datën e cila është shënuar në Procesverbal- 23 korrik 2010*. Nuk ka mospërputhje ndërmjet tyre, duke përfshirë edhe ato të cilat përjashtojnë parregullsitë e kësaj seance ose arsyetojnë mungesën e paditësit dhe përfaqësuesit të tij gjatë seancës. Supozimi sipas Nenit 329, paragrafi 1 LPK për vërtetësinë e asaj çka është thënë në Procesverbalin e datës 14 korrik 2010 nuk është demantuar në këtë rast sipas Nenit 329, paragrafi 3 LPK. *Së pari*, deklaratimet e ankuesve se data e seancës për shqyrtim kryesor e lajmëruar verbalisht nga ana e Gjyqtarit ishte 23 gusht 2010 nuk paraqet pranim sipas Nenit 321, paragrafi 1 LPK të fakteve të cilat janë të pafavorshme për ata, por pretendimet e fakteve që janë më të favorshme për ata, pa efekt provues. *Së dyti*, me nënshkrimin e Procesverbalit të datës 14 korrik 2010 pa ndonjë kundërshtim ankuesit pranuan, siç parashihet me Nenin 139, paragrafi 1 LPK, saktësinë e tij, *ndër të tjera*, saktësinë e datës së shënuar së seancës kryesore – 23 korrik 2010. *Së treti*, Avokati SHEMSEDIN PIRAJ nuk ka mundur të ftohet për seancë për të deklaruar *“datën e saktë të pranuar për mbajtjen e seancës për shqyrtim kryesor”*, siç është propozuar në ankesë të ISA SALIHU. Sipas Nenit 208 *in fine* LPK, në procedurë të tanishme seanca dëgjimore direkte e lëndës nga ana e Gjykatës së shkallës së dytë është e ndaluar në mënyrë eksplicite. Për atë, nuk lejohen dëshmitarët, duke përfshirë këtu përfaqësuesit e autorizuar të palëve në procedurë - Neni 342, paragrafi 1, pika a) LPK, me që ata mund të dëshmojnë vetëm gojarisht sipas Nenit 347, paragrafi 1 LPK derisa iu përgjigjet pyetjeve të parashtruara nga palët dhe nga Gjykata gjatë marrjes në pyetje sipas Nenit 348 LPK të mbajtur në seancë publike. Për atë, thëniet e Avokatit SHEMSEDIN PIRAJ nuk mund të merren tani si provë – ai nuk mund të thirret nga kjo shkallë e Gjykatës për të dhënë deklaratë sipas Nenit 339, paragrafi 1 LPK meqenëse nuk mund të dëgjohet asnjë dëshmitar në këtë procedurë ankimore për shkak të ndalesës së domosdoshme për shqyrtimin e drejtpërdrejtë të çështjes në një seancë sipas Nenit 190, paragrafët 2 – 4 LPK të themeluar në bazë të Nenit 208 *in fine* LPK, në njërën anë. Në anën tjetër, deklaratat me shkrim të këtij, sikurse edhe të dëshmitarëve të tjerë kryesisht janë të papranueshme - neni 347, paragrafi 1 LPK. Për sa i përket deklaratave të përfaqësuesit të autorizuar të njëjtë të paditësit, të përfshira në ankesë, këto janë

pretendimet në emër të palës ndërgjyqëse me mungesë të fuqisë ligjore. Për sa i përket DIVNA STAMENKOVIC, nuk është propozuar asnjë dëshmi në ankesë, në pajtim me Nenin 180, paragrafi 1 lidhur me Nenin 208 LPK. Me që nuk është vërtetuar nga ana e ankuesve lidhur me barrën e tyre të provës, sipas Nenit 329, paragrafi 3 LPK, se përmbajtja e Procesverbalit e datës 14 korrik 2010 është e pasaktë në çdo element të tij sipas Nenit 135 LPK ose është përpiluar në një mënyrë të papërshtatshme, e ka efektin provues të një dokumenti publik të pranuar nga Neni 329, paragrafi 1 LPK. Bazuar në këtë, kjo instancë është e lidhur me ligj për ta pranuar Procesverbalin e seancës përgatitore të datës 14 korrik 2010 me çka dëshmon vërtetësinë e datës të caktuar për seancën e shqyrtimit kryesor- 23 korrik 2010, siç edhe është shënuar në te.

36. Nuk ka pasur arsyë për shtyerjen e seancës së 23 korrikut 2010 me që të gjitha kushtet ligjore for fillimin e saj janë përmbushur- Neni 437, paragrafi 1 LPK. *Së pari*, Palët janë thirrur sipas rregullit për seancë përgatitore me 14 korrik 2010 sipas Nenit 421, paragrafi 1 LPK. *Së dyti*, mungesa e SAVIC SMILKA dhe DIVNA STAMENKOVIC dhe përfaqësuesve të tyre nuk mund të pengoj mbajtjen e shqyrtimit kryesor me 23 korrik 2010 me që, siç është cekur më lartë, këto të paditurat janë njoftuar për këtë në seancën e mëparshme me 14 korrik 2010. *Së treti*, nuk ka pasur asnjë propozim të veçantë nga palët për shtyerjen e shqyrtimit kryesor mbi bazat e parapara me Nenin 438, paragrafi 1, pika a) LCP, e as ndonjë propozim i përbashkët nga të gjitha palët sipas Nenit 438, paragrafi 1, pika b) LPK. Me që të gjitha kriteret procedurale për fillimin e shqyrtimit kryesor me 23 korrik 2010 ishin përmbushur dhe nuk kishe baza ligjore për shtyerjen e saj dhe ricaktimin e datës së re, mungesa e paditësit në seancën përkatëse ishte barazuar ligjërisht nga ana e Gjykatës së shkallës së parë për tërheqjen e padisë bazuar në Nenin 423, paragrafi 3 LPK.


37. Paditësi ISA SALIHU ishte *thirrur sipas rregullit* për seancë kryesore të datës 23 korrik 2010 siç kërkohej nga Neni 423, paragrafi 3 LPK. *Së pari*, ai vet dhe përfaqësuesi i tij i autorizuar Avokati SHEMSEDIN PIRAJ ishin të pranishëm në seancën përgatitore dhe gjatë saj që të dytë u njoftuan për Aktvendimin sipas Nenit 420, paragrafi 1 LPK, duke përfshirë pjesën e parë nën pikën a) për caktimin e datës dhe kohës. Prandaj, duke u bazuar në rregullin e Nenit 421, paragrafi 1 LPK paditësit nuk është dashur t'i dërgohet ky Aktvendim dhe/apo thirrja për seancë kryesore sepse ai është njoftuar për këto. *Së dyti*, në pajtim me Nenin 421, paragrafi 2 LPK ai ishte i obliguar nga Gjykata e shkallës së parë të jetë i pranishëm në seancën për shqyrtim kryesor për të degjuar si palë në procedurë, sikurse edhe është njoftuar për pasojat procedurale të mosparaqitjes së tij. *Së treti*, me që nuk janë krijuar mospërputhje sipas Nenit 329, paragrafi 3 LPK ndërmjet datës së shqyrtimit kryesor, të shprehur verbalisht nga Gjyqtari në seancën përgatitore, dhe asaj të shënuar në Procesverbal me shkrim, Gjykata e shkallës së dytë, duke u bazuar në efektin provues si një dokument zyrtar - Neni 329, paragrafi 1 LPK duhet të vendos se paditësi është njoftuar sipas rregullit në pajtim me Nenin 421, paragrafi 1 LPK për seancë të shqyrtimit kryesor me 23 korrik 2010 dhe *anasjelltas* jo për seancë të 23 gushti 2010, siç ka pretenduar në ankesën e tij.

38. Të dytë, ISA SALIHU dhe përfaqësuesi i tij Avokati SHEMSEDIN PIRAJ *munguan në seancën për shqyrtim kryesor me 23 korrik 2010*, i cili fakt është pranuar

në ankesë të këtij ankuesi dhe është shënuar në Procesverbalin e kësaj seance. Nuk kanë ekzistuar çfarë do arsye të pranueshme për mosparaqitje në seancë që nuk ka mundur të parashihet apo të mënjanohet. Gjykata e shkallës së parë nuk është njoftuar për asnjë nga rrethanat *objektive* që pengojnë pjesëmarrjen personale të paditësit dhe/apo përfaqësimin e tij në seancë kryesore, para mbajtjes së saj apo më pas. Asnjëherë nuk është prezantuar ndonjë provë lidhur me këtë. Përkundrazi, bazuar pohimin në ankesë të ISA SALIHU, të dytë, ai dhe përfaqësuesi i tij Avokati SHEMSEDIN PIRAJ nuk ishin të angazhuar me punë me 23 korrik 2010 dhe ishin në gjendje të marrin pjesë në seancë në atë datë. Me që mungesa e tyre, sipas kritereve ligjore të përcaktuara me Nenin 129, paragrafi 1 LPK, ishte e pajustificuar, asnjë propozim i paditësit bazuar në atë dispozitë për kthim në gjendjen e mëparshme në seancën për shqyrtim kryesor nuk është parashtruar në GjK të GJILANIT sipas Nenit 130, paragrafi 1 LPK brenda afatit 7 ditësh sipas Nenit 130, paragrafi 2 LPK. Pra, nuk është marrë ndonjë Aktvendim mbi lejimin në kthim të gjendjes së mëparshme sipas Nenit 133, paragrafi 3 LPK. Kjo përjashton anulimin e Aktvendimit të ankimuar sipas Nenit 129, paragrafi 2 LPK për shkak se pasojat e *mungesës* së paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor të paraparë me Nenin 423, paragrafi 3 LPK nuk janë tërhequr përmes këtij mjeti të aplikueshëm ligjor. Ato nuk janë larguar me prezencën e tij në të gjitha seancat tjera dhe me parashtrësit me shkrim për vendosje urgjente të lëndës, siç është shkruar në ankesë. Kjo për shkak se aplikimi i Nenit 423, paragrafi 3 LPK varet ekskluzivisht dhe vetëm nga mungesa e paditësit në shqyrtimin kryesor, dhe jo nga veprimet e tij të mëparshme procedurale në lëndë.

39. Të gjithë të paditurit, pa përjashtim, ishin të pranishëm ose të përfaqësuar rregullisht në seancën përgatitore dhe kështu kanë qenë edhe të njoftuar në atë seancë sipas Nenit 421, paragrafi 1 LPK për Aktvendimin me të cilin është caktuar seanca për shqyrtim kryesor sipas Nenit 420, paragrafi 1 LPK. Të gjithëve i është dhënë nga ana e Gjykatës së shkallës së parë e drejta e pranuar me Nenin 423, paragrafi 3 LPK për të kërkuar që shqyrtimi kryesor të mbahet në mungesë të paditësit. Kjo gjithashtu vlen edhe për ankuesën DIVNA STAMENKOVIC – në seancën e datës 14 korrik 2010 ishte i pranishëm përfaqësuesi i saj i autorizuar Avokati EKREM PIRA, pra, ajo ishte e njoftuar sipas rregullit përmes atij për seancën e ardhshme me 23 korrik 2010 në pajtim me Nenin 421, paragrafi 1 dhe Neni 107, paragrafi 1 LPK. Me që Autorizimi i tij ishte nënshkruar nga DIVNA STAMENKOVIC me një fushëveprim të autorizimit të përgjithshëm (Neni 90, paragrafi 2 LPK), njoftimi i këtij përfaqësuesi ka të njëjtin efekt ligjor sikurse të ishte ndërmarrë në lidhje me këtë palë - Neni 86, paragrafi 2 LPK. Deklarata e Avokatit EKREM PIRA është jorelevante e dhënë në fund të seancës përgatitore se për shkak të ekonomizimit të procedurës duke marrë parasysh pranimin e padisë nga ana e klientit të tij DIVNA STAMENKOVIC, ata nuk kishin me u paraqit në seancën e rradhës. Gjykata ka urdhëruar të mos thirret në seancë për shqyrtim kryesor kjo e paditur për shkak të njoftimit në seancën përgatitore sipas Nenit 421, paragrafi 1 LPK, por jo për shkak të deklaratës së përfaqësuesit të saj të autorizuar për mosparaqitjen në seancën e rradhës.

40. Të njoftuar rregullisht për seancën e shqyrtimit kryesor asnjëri nga të paditurit të pranishëm apo të përfaqësuar në seancën e datës 23 korrik 2010 *nuk kanë kërkuar që seanca të mbahet në mungesë të paditësit*. Përkundrazi, të gjithë unanimisht i



propozuan Gjykatës të aplikoj Nenin 423, paragrafi 3 LPK dhe në bazat e këtij Neni të konsideroj padin të tërhequr. Në pajtim me Nenin 135 LPK prezenca/mungesa e çdë njërit nga të paditurit dhe të përfaqësuesve të tyre të përkohshëm apo të autorizuar janë shënuar sipas rregullit në Procesverbalin e seancës, sikurse edhe propozimet e tyre si në Nenin Article 423, paragrafi 3 LPK. Dipozita *nuk kërkon ekzistimin e interesit ligjor* për bazueshmërinë e këtyre deklaratave, *e as justifikimin e tyre në çfarë do forme apo momenti*. Këtë argumente në ankesën e parë janë të pabazuar-mungesa e kërkesës nga të paditurit për vazhdimin e procedurës në minuesë të paditësit është i *mjaftueshëm* për aplikimin e Nenit 423, paragrafi 3 LPK, pavarësisht nga arsyet faktike apo ligjore për këtë pozicion ose për formën e shprehjes së tij. Në anën tjetër, me përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor me 23 korrik 2010, afatet përjashtuese për deklaratat e tilla kaluan duke ndërprerë të drejtën e të paditurve për t'i tërhequr ato më pas. Për atë shkak, kërkesa e JOVAN FILIPOVIC për vazhdimin e procedurës të paraqitur në përgjigjen e tij të datës 1 shtator 2010 është pa efekt ligjor-*së pari*, vërtetësia e përgjigjes nuk është e legalizuar zyrtarisht bazuar në dispozitat e aplikueshme për dokumentet e nënshkuara nga personat e huaj; *së dyti*, deklarata është dashur të jepet deri në fund të seancës kryesore me 23 korrik 2010 si afat përjashtues për veprim procedural të këtij lloji; *së treti*, është inkorporuar në përgjigje sipas Nenit 187, paragrafi 1 lidhur me Nenin 208 LPK të dorëzuar pas kalimit të afatit të paraparë prej 7 ditësh për ushtrimin e saj dhe sipas rregullës së domosdoshme të Nenit 187, paragrafi 4 lidhur me Nenin 208 LPK nuk duhet të konsiderohet nga shkalla e dytë.

41. Konkluzioni i marrë pas vlerësimit të arsyeve sipas Nenit 181, paragrafi 1, pika a) lidhur me Nenin 208 të kërkuar në ankesat është se Aktvendimi C.nr.705/04 i GjK të GJILANIT, i datës 23 korrik 2010 është marrë pa shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore sipas Nenit 182, paragrafi 1 lidhur me Nenin 208 LPK – Neni 423, paragrafi 3 LPK sepse baza ligjore e tij nuk është aplikuar në mënyrë të gabueshme nga ana e Gjykatës së shkallës së parë në prezencë të gjitha kushteve të parapara me mendimin për ndërprerjen e procedurës me tërheqjen e konsideruar të padisë.


42. Aktvendimi i atakuar nuk ka mundur të anulohet gjithashtu për shkak të përmbajtjes së pakuptueshme sipas Nenit 182, paragrafi 2, pika n) LPK, siç është kërkuar në ankesë të ISA SALIHU. Ai përmbanë të gjitha elementet e domosdoshme të parapara në Nenin 160, paragrafi 1 lidhur me Nenin 175 LPK – pjesën hyrëse, diapozitivin, arsyetimin dhe udhëzimin për sa i përket të drejtës për tu ankuar. Domethënë, pjesa hyrëse është përpiluar me të gjitha elementet e nevojshme që janë numëruar në Nenin 160, paragrafi 2 lidhur me Nenin 175 LPK - Gjykatën, emrin dhe mbiemrin e Gjyqtarit, emrat dhe mbiemrat, vendbanimet e palëve në procedurë, përfaqësuesit e tyre, përshkrim të shkurtur të objektit të kontestit dhe vlerën e tij, dhe ditën kur merret ai Aktvendim. Për sa i përket vendbanimit të SHABAN, VEHBI, FIDAN, FATON, RUHAN dhe SEBAHATE SALIHU, është shënuar ashtu siç është verifikuar së fundi në seancën e 23 korrikut 2010 – për të parin, për të dytin dhe për të tretin është shkruar si vendbanimi i tyre i *përkohshëm*- fshati LIVOC I POSHTEM, Komuna e GJILANIT, ndërsa për të katërtin, pestin dhe gjashtin- si vendbanim i tyre i *përkohshëm*- në Zvicër, një alternative e lejuar me Nenin 160, paragrafi 2 lidhur me

Nenin 175 LPK. Për atë, nuk ka pasaktësi në veçimin e palëve çka e bënë Aktvendimin e atakuar të pakuptueshëm. Për më tepër, kjo mungesë mund të paraqet bazë sipas Nenit 182, paragrafi 2, pika n) LPK nëse ndikon në arsyetim ose në diapozitiv, por jo në pjesën hyrëse të aktit gjyqësor. Si tërësi, Aktvendimi i atakuar është marrë me formën dhe përmbajtjen që korrespondon me ato të parapara sipas ligjit ligjit.

43. Ankesa e ISA SALIHU përshkruan në detaje seancën përgatitore të datës 14 korrik 2010 për sa i përket deklaratave të palëve mbi arsyet e kontestit dhe veprimeve të tjera procedurale të ndërmarra gjatë procedurës. Në atë pjesë ankesa nuk përmbanë baza sipas Nenit 178, pika c) lidhur me Nenin 208 LPK për ta atakuar Aktvendimin C.nr.705/04 të GjK të GJILANIT, të datës 23 korrik 2010 dhe si e till nuk duhet të konsiderohet gjatë shqyrtimit ankimor. *Së pari*, pas tërheqjes së padisë, duke përfshirë edhe atë të konsideruar sipas Nenit 423, paragrafi 3 LPK, duhet të konsiderohet se nuk është paraqitur asnjëherë në Gjykatë – Neni 261, paragrafi 5 LPK, çka përjashton vendosjen e saj në procedurë të njëjtë kontestuese në cilën do shkallë. *Së dyti*, në këtë fazë ankimore shkalla e dytë nuk është e autorizuar, sipas Nenit 209, pikat a) – d) LPK, të vendos në këtë kontest me që është tërhequr, as padia nuk mund të aprovohet, e as të refuzohet – Neni 2, paragrafi 1 LPK. Për atë, arsyet në ankesën e ISA SALIHU të cilat ripërsërisin pretendimet në padinë e tij për sa i përket pronësisë së palujatshmërsisë së kontestuar nuk do të analizohen ose vendosen- me që ato nuk krijojnë bazë, sipas Nenit 178, pika c) lidhur me Nenin 208 LPK, për ta atakuar Aktvendimin C.nr.705/2004 e GjK të GJILANIT, të datës 23 korrik 2010, nuk bien nën fushëveprimin e shqyrtimit ankimor, dhe për më tepër, aplikimi i gabueshëm i drejtës materiale nuk mund të jetë i kontrolluar *sipas detyrës zyrtare* nga Gjykata e shkallës së dytë pas ankesës, sipas Nenit 206 LPK, gjë që nuk është kundër Aktgjykimit por kundër Aktvendimit.

44. Nuk janë përcaktuar shkeljet e procedurës kontestimore, sipas Nenit 182, paragrafi 2, pikat b), g), j), k) dhe m) lidhur me Nenin 208 LPK, të cilat Gjykata e shkallës së dytë është e obliguar t'i ekzaminoj *sipas detyrës zyrtare*. Kjo vlenë në veçanti për pjesën e dytë të Aktvendimit të atakuar për sa i përket pagesës së përfaqësuesve të përkohshëm me që nuk janë kërkuar shpjegimet nga ankuesit për atë. Me që emërimi i tyre është bërë për shkak të adresave të panjohura të të paditurve - Neni 79, paragrafi 3 LPK (deri me 6 tetor 2008 i përgjigjet Nenit 84, paragrafi 2, pika 5 të Ligjit mbi Procedurë Kontestimore), GjK e GJILANIT vendosi në pajtim me Nenin 81, paragrafi 2 LPK se harxhimet e tyre duhet të mbulohen prej mjeteve të depozituara nga paditësi. Vendimi është marrë pas kërkesës së veçantë të përfaqësuesit të përkohshëm të paraqitur në seancën kryesore, përmes Aktvendimit duke përfunduar procedurën në Gjykatën e shkallës së parë, në pajtim me Nenin 463, paragrafët 1, 3 and 4 LPK. Pagesa e shumave përkatëse të parave dhe kthimi i pjesës së papërdorur të mjeteve të depozituara nga paditësi, është vendosur gjithashtu në pajtim me Nenet 7, 8 dhe 9 të Cirkularit të Departamentit për Administrim Gjyqësor nr.09/77.03, të datës 21 mars 2005, Neni 389, paragrafi 1, pika 2 dhe Neni 390, paragrafi 1 të Rregullave për Veprimtari Interne të Gjykatave.

Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike - Neni 183 LPK



45. Shkaqet, sipas Nenit 181, paragrafi 1, pika b) LPK, e kërkuara vetëm në ankesën e parë nuk mund të arsyetohet aprovimin e saj. *Së pari*, formulimi i saj është më se i zbrazët – teksti i dipozitës është i cituar fjalë për fjalë pa konkretizimin e bazuar në përmbajtjen e Aktvendimit të atakuar. *Së dyti*, me kishit që ky shkak, sipas definicionit në Nenin 183 LPK, ekziston vetëm kur Gjykata vërteton një *fakt material* në mënyrë të gabuar ose nuk arrin ta vërtetojë, atëherë është i pazbatueshëm për ankesat kundër Aktvendimeve përmes të cilave Gjykata nuk vendos për padi, duke përfshirë bazat faktike, por për çështjet lidhur me procedurën- Neni 142, paragrafi 5 LPK. *Së treti*, edhe nëse Neni 181, paragrafi 1, pika b) LPK konsiderohet i aplikueshëm për ankesat, sipas Nenit 206 LPK, në rastin konkret, siç është cekur më lartë, Gjykata e shkallës së parë vërtetoi në mënyrë të drejtë të gjitha faktet e përshtatshme për aplikimin e Nenit 423, paragrafi 3 LPK – caktimi i shqyrtimit kryesor për datë 23 korrik 2010, mungesa e paditësit të thirrur sipas rregullit si dhe të përfaqësuesit të tij të autorizuar, dhe mungesa e kërkesave të të paditurve për vazhdimin e procedurës. Nuk ka fakte brenda fushëveprimit të të Nenit 423, paragrafi 3 LPK të cilat Gjykata e shkallës së parë i ka vërtetuar në mënyrë të gabuar ose nuk ka arritur ti vërtetojë, pra nuk ekziston vërtetimi i gabuar ose jo i plotë i gjendjes faktike për sa i përket Nenit 181, paragrafi 1, pika b) lidhur me nenin 183 dhe Nenin 208 LPK.

VII. Konkluzion

46. Nuk është vërtetuar baza ligjore, sipas Nenit 181, paragrafi 1, pikat a) dhe b) lidhur me Nenin 208 LPK, pas shqyrtimit ankimor, sipas Nenit 194 lidhur me Nenin 208 LPK. Aktvendimi i atakuar C.nr.705/04 i GjK të GJILANIT, të datës 23 korrik 2010 është marrë në praninë e të gjitha kushteve, sipas Nenit 423, paragrafi 3 LPK, në pajtim me procedurën për marrjes a tij të përcaktuar me Nenin 170 LPK, me formën dhe përmbajtjen të paraparë me Nenin 160, paragrafi 1 lidhur me Nenin 175 LPK. Për atë, ankesat refuzohen dhe Aktvendimi i atakuar, i marrë sipas ligjit, vërtetohet nga Gjykata e shkallës së parë, sipas Nenit 209, pika b) LPK.

Duke marrë parasysh arsyetimin e sipërpërmendur është vendosur si në diapozitiv.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi nuk lejohet ankesa


GJYKATA E QARKUT E GJILANIT AC. nr.327/2010 me 20.04.2011

KRYETARE E TRUPIT GJYKUES

ROSITZA BUZOVA

Përkthyer nga anglishtja në shqip nga:

Xhangyle Ilijazi, perkthyes ne EULEX,

Prokuroria e Korceve
Prokuroria e Korçës
KARTËSINË E KRYETARËS GJYKËSIAVE TË QARKUT
TË TACHOST OTPRALNA POTVODILICE

Prokuroria e Korçës
Kryetare e Trupit Gjykoës
